

BURIMET UJORE DHE KAPTAZHET

Përshkrimi i kursit

Përzgjedhja e duhur e burimeve ujore si dhe menaxhimi i mirë rezervuarëve janë faktorë kryesor dhe shumë të rëndësishëm për prodhimin e ujit me cilësi të mirë dhe kosto të ulët. Nëse cilësia e ujit është e mirë që në burim apo rezervuar, atëherë dhe kaptazhet do të ofrojnë ujë të pastër dhe në mënyrë efektive për tek impianti i trajtimit apo në rrjetin shpërndarës.



Në këtë kurs trajnimi pjesëmarrësit do të marrin njohuritë bazë mbi burimet ujore dhe karakteristikat e tyre. Do të trajtohen dhe diskutohen programet dhe metodat e menaxhimit të rezervuarëve dhe avantazhet e tyre. Gjithashtu, do të identifikohen dhe përshkruhen llojet e kaptazheve si dhe procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinierët e prodhimit dhe inxhinierët projektues.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Njihni ciklin hidrologjik;
- Njihni karakteristikat fizike, kimike dhe biologjike të ujrave sipërfaqësor dhe nëntokësorë;
- Vlerësoni qendrueshmërinë e burimeve të ujit për qëllim pirjeje;
- Njihni faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit;
- Njihni avantazhet e zbatimit të një programi për menaxhimin e rezervuarëve;
- Zbatoni metodat e duhura për menaxhimin e rezervuarëve për përmirësimin e cilësisë së ujit;
- Operoni dhe mirëmbani në mënyrë të sigurt kaptazhet.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Burimet Ujore dhe Kaptazhet". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.